Kronikë

Po kryenin gjueti të paligjshme, arrestohen 5 persona në Shkodër! Sekuestrohen armë e kanabis

Në automjetin me të cilin po udhëtonin këta persona, policia gjeti dhe sekuestroi 1 armë zjarri pistoletë, 1 armë zjarri pushkë, 1 armë gjahu teke, 1 armë gjahu shotgan, municion luftarak, 1 dron dhe 1 shpend i vrarë.

Redaksia
24 Tetor, 13:19 | **Përditesimi: 24 Tetor, 13:22**

Share

Pesë persona janë arrestuar në fshatin Rragam të Shkodrës pasi po kryenin gjueti në kundërshtim me ligjin.

Personat e arrestuar janë E. F., 30 vjeç, E. M., 36 vjeç, K. D., 36 vjeç, V. N., 29 vjeç dhe S. S., 23 vjeç, të gjithë banues në Shkodër.

Në automjetin me të cilin po udhëtonin këta persona, policia gjeti dhe sekuestroi 1 armë zjarri pistoletë, 1 armë zjarri pushkë, 1 armë gjahu teke, 1 armë gjahu shotgan, municion luftarak, 1 dron dhe 1 shpend i vrarë.

LEXO EDHE:
Ekspozita/ Piktorët e peisazhit hedhin në telajo pamjet magjepse nga vjeshta në Theth e Bogë

Ndërkohë në banesën e njërit prej të arrestuarve, E. M., 36 vjeç u gjet dhe një sasi e vogël kanabis, gjithashtu e sekuestruar në cilësinë e provës materiale.

"Shkodër/Zhvillohen kontrolle në zbatim të planit të masave për parandalimin dhe goditjen e rasteve të gjuetisë së paligjshme.

Finalizohet operacioni i koduar "Hunters".

Vihen në pranga 5 shtetas që u kapën në flagrancë gjatë natës, në fshatin Rragam, duke kryer gjueti, në kundërshtim me moratoriumin e gjuetisë.

Në momentin e ndalimit nga Policia, këtyre shtetasve iu gjetën në automjet, 2 armë zjarri (1 pistoletë, 1 pushkë), 2 armë gjahu, municion luftarak, 1 dron dhe 1 shpend i vrarë.

Gjatë kontrollit në banesën e njërit prej të arrestuarve, u gjet një sasi Cannabisi.

Shërbimet e Komisariatit të Policisë Shkodër, bazuar në planin e masave të hartuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër, për parandalimin dhe goditjen e rasteve të gjuetisë së paligjshme, kanë kryer kontrolle në zona të ndryshme të qarkut Shkodër.

Gjatë kontrolleve, në fshatin Ragam, shërbimet e Policisë kanë konstatuar 5 shtetas që kryenin gjueti të paligjshme. Gjatë kontrollit në automjetin me të cilin qarkullonin këta shtetas, u gjetën: 1 armë zjarri pistoletë, 1 armë zjarri pushkë, 1 armë gjahu teke, 1 armë gjahu shotgan, municion luftarak, 1 dron dhe 1 shpend i vrarë, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Gjatë kontrollit në banesën e shtetasit E. M., shërbimet e Policisë gjetën një sasi lënde të dyshuar narkotike Cannabis Satia, e cila u sekuestrua gjithashtu në cilësinë e provës materiale.

Në përfundim të veprimeve për këtë rast, specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Shkodër arrestuan shtetasit:

E. F., 30 vjeç, E. M., 36 vjeç, K. D., 36 vjeç, V. N., 29 vjeç dhe S. S., 23 vjeç, të gjithë banues në Shkodër.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Shkodrës, për veprime të mëtejshme, për veprat penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive", "Dëmtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së eger" dhe "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", njofton policia.

K.B/rk./Shqiptarja.com

TAG: rragam Shkodër gjueti e paligjshme

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës: 23 Tetor, 14:32
Nga sa keni lexuar raportin e ODHIR për 11 majin, a vihet në dyshim fituesi?

Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera

Banorëve iu bë rrjeti elektrik gjatë fushatës së 11 majit, SPAK çon për gjykim krye-bashkiakun e PS në Vaun e Dejës, Kristian Shkreli! Kërkonte vota për PSD

Keti Banushi

24 Tetor, 08:30

Shkodër/ Era e fortë rrëzon disa pemë në rrugën 'Martin Camaj', qarkullimi u bllokua përkohësisht (VIDEO)

24 Tetor, 08:00

Me drogë e armë në makinë, në pranga dy persona në Shkodër (EMRAT)

23 Tetor, 11:20

Malësi e Madhe/ U gjet i vdekur në humnerë, familjarët dyshojnë se Mirel Çokajn e shtyu ortaku: Kishin një parcelë me kanabis së bashku

22 Tetor, 16:40

Rikonstruktohet shkolla 'Adem Haxhija' në Postribë të Shkodrës, Rama ndan pamjet

21 Tetor, 14:16

Festa e 'Zojës së Shkodrës'/ Arqipeshkvi Giovanni Peragine: Mungon qetësia në qytet, dhuna po bëhet pjesë e kulturës sonë

Ergys Kavaja

20 Tetor, 18:13

Aktivistja Fjona Bashi rrëfen betejën me kancerin e gjirit: Duhen kontrolle, frika është armiku i kësaj sëmundje

Ergys Kavaja

20 Tetor, 16:11

Tiranë/ Gjueti e paligjshme te liqeni i Prushit, arrestohet 35-vjeçari

20 Tetor, 11:54

Rama ndan pamjet: Shtigjet magjike të Lëpushës drejt Majës së Vajushës, një nga itineraret më të bukura të Parkut Kombëtar të Alpeve

20 Tetor, 08:22

Festa e Zojës së Shkodrës, procesioni i besimit dhe përkushtimit në rrugët e qytetit (VIDEO)

Ergys Kavaja

18 Tetor, 18:05

Shkodër/ Dyshohet se abuzoi seksualisht me një 26-vjeçare, nis hetimi për izraelitin

18 Tetor, 11:59

Sherr në një lokal në Bushat, 56-vjeçari qëllon me kosore 39-vjeçarin! Vihet në pranga

18 Tetor, 10:07

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje